

Më
 Data

03-09-2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR], i akuzuar sipas Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.577-1/18 të datës 13.04.2018, për veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 2 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.577-1/18 të datës 13.04.2018, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt. 25.05.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.577-1/18 të datës 13.04.2018, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDAKTUAR] i lindur më [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], me vendbanim në Prizren rr. [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR] me nr. personal [REDAKTUAR] ka të kryer shkollën e mesme, me profesion vozitës, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

Me datë 07.02.2018, rreth orës 08:20 në Shtime, rruga "Anton Qeta", përballë marketit [REDAKTUAR], i pandehuri deri sa ishte duke e drejtuar automjetin e markës "Mercedes Benz", me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], nga pakujdesia ka shkelur ligjin mbi trafikun publik dhe e ka rrezikuar jetën e njerëzve duke vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 46 par. 1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, ashtu që ka tentuar të kyçej nga parkingu në rrugën kryesore, pa u siguruar se me një veprim të tillë nuk do ti rrezikoj pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, e si pasoj e këtyre lëshimeve, goditet në pjesën e mesme të anës së majtë të automjetit, me pjesën e

përparme nga automjeti "VW Caddy", me targa të regjistrimit [REDACTED] të cilin e drejtonte [REDACTED], ku si pasojë e këtij aksidenti, lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin pëson i dëmtuari [REDACTED] dhe [REDACTED], të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 06.04.2018,-

-me të cilën ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.6 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,23,41,46 dhe 73 të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së:

G J Y K O N

Të akuzuarin, me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par. 3 të KPRK-së, i njëjti do të shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do të llogaritet 1(një) ditë burg.

Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit ta paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë euro), brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 60.88 €, në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.577-1/18 të datës 13.04.2018, ka akuzuar të akuzuarin [REDACTED] për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni

378 par. 6 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkëmor PP/II.nr.577-1/18 të datës 13.04.2018, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i akuzuari.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkëmor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkëmor, në vështrim të nenit 495 par 1. të KPPK-së.

Gjykata pasi shqyrtoj provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: konstatimi i ekspertit mjeko ligjor Dr. [REDAKTUAR] e datës 06.04.2018, konstatimi dhe mendimi i ekspertit të komunikacionit rrugor MSc. Ing. [REDAKTUAR] e datës 12.03.2018, skica dhe fotografitë e vendit të ngjarjes-aksidentit të komunikacionit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërtetojnë se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqipton dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 39 par. 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës penale në shumën prej 60.88 €, në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.*

Nga arsyet e sipër cekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.543/18, me datë 25.05.2018

Zyrtarja ligjore
Ganimete Avdiu

Gjyqtarja Individuale

Hakile Ilazi



KËSHILLË JURIDIKE:

Kudër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.